



Pranuar / Dorezuar Prilijeno/Prodato Received/Delivered	14.04.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Org./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SIQIMSHICK	2123/2022		1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.216/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.216/2022 të datës 09.03.2022 të parashtruar nga me adresë kundër organit të punësimit/Ministrisë të Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 14.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.216/2022 e datës 09.03.2021 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, më datë 09.03.2022, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër shuarjes së pozitës së Drejtorit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës sipas Rregullores Nr.01/2022 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje referuar Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 10.03.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (*me tej MPJD*), ndërsa kjo e fundit më datë 11.03.2022 ka përcjellë përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar

këto prova: Ankesën A.nr.216/2022 të datës 09.03.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me nr.ref.40/2021 të datës 22.02.2021 për zbatimin e vendimit të KPMSHCK A.nr.413/2020; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 10.03.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 14.03.2022; Akt Emërimit të datës 133.12.2012 për ankuesin; Ndryshim dhe Plotësimin e Aktit të Emërimit të datës 23.10.2013; Vendimin me numër protokollit 304 të datës 24.02.2022 për themelimin e Komisionit të Ristrukturimit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Vendimin Nr. 03/65 të datës 08.03.2012 të Qeverisë së Kosovës për themelimin e Akademisë Diplomatike të Republikës së Kosovës; Vendimin nr.ref.1048/2012 të datës 16.10.2012 për emërimin e Drejtorit të Akademisë Diplomatike; Vendimin e datës 13.05.2016 për emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Akademisë Diplomatike; Miratimin paraprak nr.0819 i datës 24.12.2021 i Ministrisë së Punëve të Brendshme lidhur me Rregulloren Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës; shkresë 001/2022 të datës 11.01.2022 të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve lidhur me vlerësimin e ndikimit buxhetor të draft Rregullore për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Vendimin Nr.214/2022 të datës 01.02.2022 të Kryeministrit të Republikës së Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar që janë të pa bazuar pretendimet ankimore të ankuesit

sepse:

Nga shqyrtimi i provave të lëndës rezulton se ankuesi në bazë të Ndryshimit dhe Plotësimit të Akt Emërimit të datës 23.10.2013 është emëruar dhe ka ushtruar pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm në Zyrën e Drejtorit të Përgjithshëm pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme tani Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Me Vendimin Nr.214/2022 të datës 01.02.2022 të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, është miratuar Rregullorja Nr.01/2022 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, e cila është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më datë 01.02.2022, ndërsa e njëjta ka hyrë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit të saj gjegjësisht me datë 08.02.2022.

Më tej, sipas shkresave të lëndës Kolegji, ka gjetur se lidhur me Draft Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporë, Ministri i Punëve të Brendshme përmes Mendimit paraprak me nr.0819 të datës 24.12.2021 ka dhënë vlerësimin se Draft Rregullorja është hartuar në pajtim me Ligjin Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 01/2020 për Standardet e Organizimit të Brendshëm, Sistematizimin e Vendeve të Punës në Institucionet e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, ndërsa Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve përmes shkresës me reference 001/2022 të datës 11.01.2022 ka lëshuar vlerësimin e ndikimit buxhetor lidhur me draft Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Sipas Rregullore Nr.01/2022 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, gjegjësisht sipas nenit 4 të kësaj Rregullore, kjo ministri është organizuar në strukturën: 1.1 Kabineti i Ministrit; 1.2. Zyra e

Sekretarit të Përgjithshëm; 1.3. Departamentet, dhe 1.4. Divizionet, rrjedhimisht me këtë Rregullore nuk parashihet pozita e Drejtorit të Përgjithshëm.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit se shuarja e pozitës së Drejtorit të Përgjithshëm është në kundërshtim me kreun II të Ligjit Nr. 03/L-122 për Shërimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, Kolegji bazuar në dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.01/2020 për Standardet e Organizimit të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Institucionet e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, vlerëson se organizimi i brendshëm dhe sistematizimi i vendeve të punës përcaktohet varësisht nga fushëveprimi, lloji dhe kompleksiteti i detyrave dhe përgjegjësi të institucionit, me qëllim të zbatimit të mandatit ligjor, si dhe sigurimit të performancës së tyre efektive, e mbi këtë bazë rezulton se mbetet në diskrecion të institucionit që të vendos lidhur me strukturën e brendshme të organizimit dhe funksionimit në mbështetje të parimeve të lartcekura.

Kolegji, në funksion të shqyrtimit të pretendimeve të ngritura në ankesë ju referua edhe nenit 54 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura me të cilin është përcaktuar se: *Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji i Administratës Shtetërore nr. 03/L-189 i Republikës së Kosovës dhe çdo dispozitë tjetër në kundërshtim me këtë lig, si dhe nenit 12 Rregullores (QRK) Nr.01/2020 për Standardet e Organizimit të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Institucionet e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura ku shprehimisht është përcaktuar detyrimi i institucioneve të administratës shtetërore që në afat kohor prej gjashtë (6) pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje të hartojnë Rregulloret përkatëse për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës.*

Në kuptim të dispozitave të Udhëzimit Administrativ Nr.03/2013 për Standardet e Hartimit të Akteve Normative, rezulton se Rregullorja për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës është akt i karakterit normativ që ka të bëjë më organizimin e brendshëm dhe funksionimin e këtij institucioni, e si rrjedhojë vlerësimi i ligjshmërisë dhe pajtueshmërisë përkitazi me zbatimin e standardeve nga Institucionet e Administratës Shtetërore me rastin e Hartimit të Rregullores për Organizimi e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës, është përgjegjësi e ministrisë gjegjëse për administratë publike, e mbi këto arsye Kolegji konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka kompetencë lëndore që të vlerësoj ligjshmërinë e akteve të natyrës së tillë.

Po ashtu, Kolegji në mbështetje të nenit 2 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë konstaton se *Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejtë në KPMSHCK për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji, ndërlidhur me këtë neni 13 i Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative parasheh se: Përveç kur përjashtohet shprehimisht me ligj, secili person ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative dhe ato gjyqësore, në mënyrën e përcaktuar me ligj, kundër një veprimi apo mosveprimi administrativ të organit publik që i cenon një të drejtë apo një interes juridik. Andaj në kuptim të këtyre dispozitave ligjore dhe duke nisur nga gjendja faktike e konstatuar si me lartë, Kolegji konstaton së ankuesi i prekur me procesin e ristrukturimit të organit të punësimit i garantohet e drejta e përcaktuar me nenin 54 të Ligjit Nr.06/L-114 për*

Zyrtaret Publikë, kështu që çdo veprim apo mos veprim i organit të punësimit në kundërshtim me këto dispozita ligjore përbën shkak të kundërshtimit me mjete juridike.

Ashtu siç u tha me sipëri, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.216/2022

Avdyl BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës ;
- Arkivit të KPMSHCK-së